



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1935/Prot.
3

Tiranë, më 05.02.2015

VENDIM

Nr. 16, datë 05/02/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1935 Prot., datë 22.12.2014, ndaj autoritetit publik/ Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi nëpërmjet shkresës nr.285/2014 Prot., datë 26.11.2014, vërtetuar kjo me recetën postare nr. RR954436575AA, datë 26.11.2014, ka kërkuar nga FSHF, *Kopje të vendimit të Komisionit të disiplinës të UEFA-s për ndeshjen Serbi - Shqipëri*. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se, kërkesa nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Federata Shqiptare e Futbollit. Pas pritjes së përgjigjes brenda afatit 10 ditë pune të përcaktuar në nenin 15 të ligjit për të drejtën e informimit, ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik/FSHF. Komisioneri, në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas së cilës për shqyrtimin e praktikës mund të informohet nga çdo person dhe *burim tjetër*, paraprakisht me shkresën nr.1935/1 Prot, datë 12.01.2015, ka vlerësuar të marrë opinion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëse FSHF bën pjesë në përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rrjedhojë e të cilës është zbatimi ose jo i kërkesave të këtij ligji. Në datë 2.02.2015 Ministria e Arsimit dhe Sportit në korrespondencën e saj bën me dije se, FSHF është autoritet publik në kuadër të ligjit të lartpërmendur dhe si e tillë ajo duhet të zbatojë kërkesat e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ministria e Arsimit dhe Sportit në opinionin e dhënë me shkresën nr.323 Prot, datë 02.02.2015, konfirmon se FSHF është ent publik dhe ka detyrimin ligjor në përputhje me nenin 2, pika 1 shkronja “b” dhe “c” të ligjit të lartpërmendur. Komisioneri konsultoi edhe faqen zyrtare të FSHF-së në kuadër të bërjes publike të

informacionit pa kërkesë dhe konstatoi se vetëm pjesa vendimore e vendimit të kërkuar nga ankuesi gjendet e publikuar në faqen zyrtare të autoritetit, ndërsa nga ankuesi kërkohet kopje e plotë e tij.

Në përputhje me ligjin nr.119/214 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti publik/ Federata Shqiptare e Futbollit, detyrohet sipas nenit 7, 14/2 dhe 16/2 të tij, të informojë ankuesin, Qendrën “Res Publica” lidhur me informacionin e kërkuar, si dhe të vendosë atë në dispozicion të ankuesit dhe të publikut në kuadër të programit të transparencës. Në rast të kundërt ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.”.*

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” kundër Federatës Shqiptare të Futbollit, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica” nr. 1935 Prot., datë 22.12.2014, kundër autoritetit publik/ Federatës Shqiptare të Futbollit, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.*
2. Urdhërimin e autoritetit publik/ Federatës Shqiptare të Futbollit, për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar, Kopje të vendimit të Komisionit të disiplinës të UEFA-s për ndeshjen Serbi – Shqipëri, brenda datës 13.02.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 05.02.2015.

